



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MBROJTJES
MINISTRI

Nr. 2797/Prot.
2

Tiranë, më 1.6.2022

URDHËR

Nr. 845, datë 1.6.2022

PËR

**PROCEDURAT DHE KRITERET E REKRUTIMIT TË KANDIDATËVE PËR
USHTAR/DETAR AKTIV NË FORCAT E ARMATOSURA QË DO TË ZHVILLOJNË
KURSIN E STËRVITJES INDIVIDUALE BAZË NË PERIUdhËN 12.09.2022-18.11.2022**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës; të shkronjës "F", të pikës 2, të nenit 13, të ligjit nr. 64, datë 26.06.2014 "Për pushtetet dhe autoritet e drejtimit e të komandimit në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar; nenit 15, pika 4, të ligjit nr. 59/2014 "Për karrierën ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar si dhe të udhëzimit të ministrit të Mbrojtjes nr. 9, datë 31.12.2018 "Për procedurat dhe kriteret e rekrutimit të ushtarëve/detarëve aktiv në Forcat e Armatosura", i ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Rekrutimi i kandidatëve për ushtar/detar aktiv në FA dhe zhvillimi i kursit të stërvitjes individuale bazë, në periudhën 12.09.2022-18.11.2022, në Qendrën e Arsimit Profesional të ushtarit në Bunavi Vlorë dhe në Repartin Ushtarak Nr. 1010 Vau Dejës e Repartin Ushtarak Nr. 1030 Poshnje të Forcës Tokësore, të bëhet sipas procedurave dhe kriterëve të përcaktuara në këtë urdhër.
2. Shtetasit shqiptarë për t'u rekrutuar ushtar/detar aktiv në FA duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme:
 - të jetë shtetas shqiptar;
 - të mos jetë në ndjekje penale dhe në proces gjykim;
 - të mos jetë dënuar nga gjykata për vepra penale;
 - të ketë figurë të pastër morale;
 - të mos jetë i deportuar për kryerje të veprave penale;

- të mos ketë probleme me drogën dhe alkolin;
- të mos jetë kontigjent krimi dhe të mos jetë i evidentuar si i tillë nga organet ligjzbatuese;
- mosha për t'u rekrutuar është 18-27 vjeç, ndërsa për specialitetin mjekësi 18-32 vjeç;
- të ketë kryer arsimin minimalisht 9 vjeçar, brenda ose jashtë vendit;
- të kenë gjatësinë trupore mbi 165 për meshkujt dhe mbi 160 cm për femrat ;
- të ketë kryer kontrollin shëndetësor dhe të jetë vlerësuar i aftë për ushtarë/detarë aktiv nga Komisioni Mjekësor Ushtarak;
- të ketë rezultuar pa probleme gjatë verifikimit të kushtit të sigurisë të kryer nga strukturat përgjegjëse.

2.1 Kandidatët për ushtar/detar aktiv në FA për këtë fazë rekrutimi të paraqesin këto dokumente për regjistrim:

- Kërkesë me shkrim;
- Fotokopje të kartës së identitetit;
- Formulari i vetëdeklarimit;
- Dy fotografi të përmasave 4x6 cm dhe dy fotografi të përmasave 9x12 cm;
- Fotokopje e noterizuar deftesës/diplomës shkollës/universitetit;
- Fotokopje e dëshmisë, certifikatës për aftësitë profesionale, gjuhësore, etj (nëse ka);
- Dokumenti i qendrës shëndetësore të lëshuar nga mjeku i familjes;
- Ekzaminimet mjekësore për agjent infektiv (Hepatit B, C, sfiliz, etj), grupin e gjakut të lëshuar nga drejtoritë e shëndetit publik ose laborator mjekësor të licencuar për këto analiza;
- Vertetim nga prokuroria, gjykata dhe dëshmi penaliteti.

2.2 Në testimin fizik dhe testimin intelektual të kandidatëve për ushtar/detar aktiv për t'u kualifikuar të përdoret kriteri i vlerësimit me renditje (listë-meritë) në raport me planin e rekrutimit. Të mos ketë minimum pikësh dhe të hiqet shprehja "kalues ose mbetës".

2.3 Kontrolli fiziko shëndetësor i kandidatëve për ushtar/detar aktiv të kryhet nga Njësia Mjekësore Ushtarake në rajonet e zhvillimit të Stërvitjen Individuale Bazë gjatë javës së parë të stërvitjes. Ekzaminime mjekësore plotësuese të kryhen vetëm për kandidatët e përcaktuar nga komisioni fiziko shëndetësor kur gjykohet e nevojshme. Qendra shëndetësore e repartit që kryen stërvitje individuale i dërgon këta kandidatë për ekzaminim të mëtejshëm në NJMU.

2.4 Në përfudim të kontrollit mjekësor, AFA e FT të dërgojnë në SHP të FA listën e kandidatë e shpallur të pa aftë nga ana shëndetësore.

2.5 Shtetasit që dëshirojnë të shërbejnë në FA si ushtar/detar aktiv, do të aplikojnë online, në Qendrën e Personel Rekrutimit ose në Seksionet e Rekrutimit në qarqe.

2.6 Procedurat, kriteret, rregullat e testimit bëhen publike në faqen e internetit të MM-së, jo më pak se 90 ditë përpara datës së fillimit të stërvitjes individuale bazë.

3. Shtabi i Përgjithshëm i FA-së (Drejtoria e Personelit) të bëjë rishikimin e planit të rekrutimit për ushtar/detar aktiv mbi bazën e nevojave të FA-së.

4. Shtabi i Përgjithshëm i FA (Drejtoria Logjistikës), të sigurojë dhe marrë masa për transportimin e kandidatëve për ushtarë/detarë nga Garnizoni "Skënderbej", AFA, për në rajonin e zhvillimit të Kursit të Stërvitjes Individuale Bazë, si dhe transportimin e personelit mjekësor të NJMU për ditët e zhvillimit të kontrollit fiziko shëndetësor të kandidatëve në rajonet e zhvillimit të Stërvitjes Individuale Bazë.
5. Njësia Mjekësore Ushtarake në Spitalin Universitar të Traumës, të marrë të gjitha masat e nevojshme për kryerjen e kontrollit dhe ekzaminimit shëndetësor të kandidatëve për ushtarë/detarë aktivë në rajonet e zhvillimit të Stërvitjes Individuale Bazë.
6. Qendra e Personel Rekrutimit të kryej të gjithë procedurën e regjistrimit dhe të testimit të kandidatëve për ushtarë/detarë aktiv duke zbatuar rregullat e mëposhtme:
 - 6.1 Regjistrimi i kandidatëve për ushtar/detar aktiv të bëhet: online; në seksionet e rekrutimit në qarqe, si dhe në Qendrën e Personel Rekrutimit.
 - 6.2 Të organizojë dhe zhvillojë testimet fizike, intelektuale dhe psikologjike, sipas kritetereve në udhëzimin e Ministrit të Mbrojtjes nr. 9, datë 31.12.2018, si dhe në pikën 2.2 të këtij urdhri.
7. Njësia Mjekësore Ushtarake (NJMU) në Spitalin Universitar të Traumës, të caktojë personelin mjekësor për kryerjen e kontrollit fiziko shëndetësor të kandidatëve për ushtar/ detar aktiv. Pagesa e personelit mjekësor, të bëhet sipas VKM nr. 656, datë 31.10.2018 "Për përcaktimin e masës së shpërblyerit të anëtarëve të këshillave, bordeve ose komisioneve të përhershëm të njësive të qeverisjes qendrore".
8. Akademia e Forcave të Armatosura (AFA) në bashkëpunim me Qendrën e Personel Rekrutimit të marrin masa për pritjen, grumbullimin dhe kompletimin me uniformë të kandidatëve për ushtar/detar aktiv.
9. Forca Tokësore (FT) dhe Akademia e Forcave të Armatosura (AFA) në bashkëpunim me Qendrën e Personel Rekrutimit të marrin masa për akomodimin, trajtimin me ushqim, zhvillimin e Stërvitjes Individuale Bazë, e në përfundim të saj, sipas kompetencës ligjore të kryejnë procedurat e titullimit "ushtar/detar aktiv", si dhe dërgimit të dokumentacionit në QPR.
10. Agjencia e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes (AISM) dhe Policia Ushtarake (PU), në bashkëpunim me struktura të tjera, të bëjë kontrollin e plotësimit të kushtit të sigurisë. Afati për verifikimin e kushtit të sigurisë të jetë 60 deri në 10 ditë para fillimit të SIB. Në raste të veçanta jo më vonë se 10 ditë para titullimit të kandidatit për ushtarë/detarë aktiv. Përgjigjja për plotësimin e kushtit të sigurisë për çdo kandidat të jetë në termin: "*plotëson kushtin e sigurisë*" ose "*nuk plotëson kushtin e sigurisë*".
11. Batalioni i Mbështetjes së Shtabit të Përgjithshëm të marrë pjesë në procesin e rekrutimit me orkestrën frymore, këshillin artistik, të mbështesë Qendrën e Personel Rekrutimit me transport për personelin e saj gjatë fushatës marketingut në qarqe/bashki, si dhe gjatë ditëve të dorëzimit

të kandidatëve për ushtarë/detarë aktiv në rajonet e zhvillimit të Stërvitjen Individuale Bazë, sipas kërkesave të QPR.

12. Për fillimin e SIB, Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA, të nxjerrë urdhërin përkatës.
13. Në përfundim të kësaj faze rekrutimi, QPR dhe AFA të informojnë Ministrin e Mbrojtjes dhe Shefin e Shtabit të Përgjithshëm të FA, për ecurinë e kësaj faze rekrutimi.
14. Për këtë periudhë rekrutimi, vlejnë përcaktimet e tjera të udhëzimit të ministrit të Mbrojtjes nr. 9, datë 31.12.2018 "Për procedurat dhe kriteret e rekrutimit të ushtarëve/detarëve aktiv në Forcat e Armatosura", i ndryshuar, përsa nuk bien në kundërshtim me këtë udhër.
15. Përgjigjen për zbatimin e këtij udhri, Shtabi i Përgjithshëm i FA, Komanda e Forcës Tokësore, Komanda e Forcës Detare, Komanda e Forcës Ajrore, Komanda Mbështetëse, Akademia e Forcave të Armatosura, Agjencia e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes (AISM), Agjencia e Sistemeve të Ndëlidhjes dhe Informacionit, Njësia Mjekësore Ushtarake, Policia Ushtarake, Batalioni i Mbështetjes së Shtabit të Përgjithshëm dhe Qendra e Personel Rekrutimit.
16. Ndjek zbatimin e udhrit Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mbrojtjes dhe Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI

Niko Peleshi

